



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 211/3 Prot.

Tiranë, më 26.01.2024

VENDIM

Nr. 3, datë 26.01.2024

PËR

KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMIN E INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT "MJEKËSI E PËRGJITHSHME" PËR KANDIDATËT QË APLIKOJNË NË KUOTAT E KATEGORIVE TË VEÇANTA, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 76 pika 2, neni 135, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, "Për testimin e informatizuar..." si dhe në vijim të Vendimit të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nr. 2, datë 10.02.2023 "Për miratimin e kriterëve të pranimit...", Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Pranimet në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit "Mjekësi e Përgjithshme", për vitin akademik 2024-2025, për:
 - a. Kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit;
 - b. Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara;
 - c. Kandidatët me statusin e jetimit;
 - d. Kandidatët Romë dhe Ballkano-Egjiptianë

bëhen bazuar në rezultatet e arsimit të mesëm dhe maturës shtetërore, si dhe në testimin e informatizuar në lëndët Biologji, Kimi dhe Fizikë që do të kryhet në QSHA¹.

2. Kandidatët sipas pikës 1, që aplikojnë për pranim në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit "Mjekësi e Përgjithshme", për vitin akademik 2024-2025, duhet të kenë notën mesatare² minimale ≥ 8.5 .

¹Fondi i pyetjeve

http://qsha.gov.al/dpsh/fondet_html/Matura%20Mjekesi/Fondi%20i%20Pyetjeve%20i%20Provimit%20te%20Informatizuar%20te%20Mjekesise.html

²Nota mesatare minimale përlllogaritet si mesatare aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm dhe mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës shtetërore.

3. Përlllogaritja e pikëve për kandidatët sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet nga:

- Pikët e fituara nga Arsimi i Mesëm (PAM) 70%
- Pikët e Testimit të Informatizuar (PTI) 30%

4. Koeficientet sipas llojeve të shkollave të mesme që do të aplikohen për vlerësimin e kandidatëve që aplikojnë në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, për vitin akademik 2024-2025, janë sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Formula e përlllogaritjes së pikëve për kryerjen e procesit të renditjes së kandidatëve që do të aplikojnë në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë në “Mjekësi e Përgjithshme” të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2024-2025, do të jetë si më poshtë vijon:

$$PP= 70\% * PAM + 30\% * PTI * KPTI^3$$

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik dhe i përcillet Fakultetit të Mjekësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Arben GJATA



³ KPTI - Koeficienti i pikëve të testimit të informatizuar

Tabela Nr. 1: Koeficientet sipas llojit të shkollës së mesme që kanë përfunduar kandidatët, të cilët aplikojnë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2024-2025:

NR	LLOJI I SHKOLLËS SË MESME	KOEFICIENTI
1	GJIMNAZ	1.4
2	SEKSION DY GJUHËSH SHQIP-FRËNGJISHT	1.4
3	SEKSION DY GJUHËSH SHQIP-ITALISHT	1.4
4	SEKSION DY GJUHËSH SHQIP-GJERMANISHT	1.4
5	GJIMNAZ ME KOHË TË SHKURTUAR	1
6	GJIMNAZ GJUHËSOR	1
7	SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	1
8	SHKOLLË SPORTIVE	1
9	SHKOLLË PEDAGOGJIKE	1
10	HOTELERI-TURIZËM	1
11	SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI	1
12	MEKANIKË	1
13	ELEKTROTEKNIKË	1
14	ELEKTRONIKË	1
15	PËRPUNIM DRURI	1
16	NDËRTIM	1
17	TEKSTIL-KONFEKSIONE	1
18	TEKNOLOGJI USHQIMORE	1
19	BUJQËSI	1
20	SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE	1
21	VETERINARI	1
22	GJEODEZI	1
23	INSTALUES SISTEMEVE TERMOHIDRAULIKE	1
24	LLOGARI	1
25	SHËRBIME BANKARE	1
26	ADMINISTRIM BIZNESI	1
27	RRJETE TË DHËNASH	1
28	MBËSHTETJE E PËRDORUESVE TË TIK	1
29	ELEKTRONIKË NË TEKNOLOGJINË E AUTOMATIZIMIT	1
30	SILVIKULTURË	1
31	HARRY FULTZ, BIZNES	1
32	HARRY FULTZ, ELEKTRONIKË	1
33	HARRY FULTZ, AUTOMEKANIK	1
34	PETER MAHRINGER TEKNOLOGJI INFORMACIONI	1
35	PROFILE TË TJERA QË NUK JANË TË LISTUARA	1